



REPUBLIKA E KOSOVËS – РЕПУБЛИКА КОСОВО - REPUBLIC OF KOSOVO

**GJYKATA KUSHTETUESE
УСТАВНИ СУД
CONSTITUTIONAL COURT**

Prishtinë, më 1 korrik 2014
Nr. ref.: MM670/14

Rasti Nr. KO103/14

Parashtrues

Presidentja e Republikës së Kosovës

**Përkitazi me vlerësimin e përputhshmërisë së nenit 84, paragrafi 14, me
nenin 95 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës**

GJYKATA KUSHTETUESE E REPUBLIKËS SË KOSOVËS

e përbërë nga:

Enver Hasani, kryetar
Ivan Čukalović, zëvendëskryetar
Robert Carolan, gjyqtar
Altay Suroy, gjyqtar
Almiro Rodrigues, gjyqtar
Snezhana Botusharova, gjyqtare dhe
Arta Rama-Hajrizi, gjyqtare

**MENDIM MOSPAJTUES I GJYQTARIT ROBERT
CAROLAN**

Shkëlqesia e Saj, Presidentja e Republikës së Kosovës, ka kërkuar që kjo Gjykatë të qartësojë se çfarë është autoriteti dhe përgjegjësia e saj sipas Kushtetutës lidhur me emërimin e Kryeministrit të Republikës së Kosovës. Ajo, gjithashtu, kërkon nga kjo Gjykatë që të qartësojë nëse ka konflikt ndërmjet nenit 84 (14) dhe 95, paragrafi 1, të Kushtetutës, lidhur me autoritetin dhe me përgjegjësitë e saj për emërimin e Kryeministrit.

Me gjithë respektin, nuk pajtohem dhe jam kundër opinionit të shumicës së kësaj Gjykate, për arsyet si në vijim.

Si kreu i shtetit, që përfaqëson unitetin e popullit, Presidentja e Republikës është apolitike. Neni 83 i Kushtetutës parasheh:

Presidenti është kreu i shtetit dhe përfaqëson unitetin e popullit të Republikë së Kosovës.

Në atë rol, kërkohet nga Presidentja që t'i propozojë Kuvendit një kandidat në mënyrë që Kuvendi ta miratojë Kryeministrin. Ky kandidat duhet të miratohet nga shumica e deputetëve në Kuvend, para se ai ose ajo të mund të emërohet nga Presidentja. Në qoftë se kandidati i emëruar nuk e ka miratimin e shumicës së deputetëve në Kuvend, ka shumë gjasa që ai ose ajo nuk do të jetë në gjendje të formojë Qeverinë, që kërkon miratimin e shumicës së deputetëve në Kuvend.

Para se ta bëj këtë propozim, Presidenti duhet së pari të konsultohet **ose** me partinë politike **ose** me koalicionin që ka fituar shumicën e nevojshme në Kuvend, jo në zgjedhjet nacionale, për ta themeluar Qeverinë. Shih nenin 95.1 të Kushtetutës. Qeveria formohet pasi merr shumicën e votave të të gjithë deputetëve të Kuvendit. Shih nenin 95.3 të Kushtetutës.

Nëse kandidati i propozuar nga Presidenti miratohet me shumicën e votave të deputetëve në Kuvend, Presidenti duhet ta emërojë Kryeministër kandidatin e suksesshëm. Shih nenin 84 (14) të Kushtetutës. Nëse kandidati i propozuar nga Presidenti nga shumica e deputetëve në Kuvend nuk miratohet nga shumica e deputetëve në Kuvend, atëherë Presidenti duhet të propozojë një kandidat tjetër, sipas të njëjtës procedurë. Nëse ajo procedurë nuk rezulton me një kandidat që merr shumicën e votave të deputetëve në Kuvend, atëherë Presidenti duhet të shpallë një tjetër raund të zgjedhjeve nacionale parlamentare. Shih nenin 95.4 të Kushtetutës.

Presidenti është i autorizuar dhe i obliguar, sipas nenit 95, paragrafi 1, të Kushtetutës:

Pas zgjedhjeve, Presidenti i Republikës së Kosovës i propozon Kuvendit kandidatin për Kryeministër, në konsultim me partinë politike ose koalicionin që ka fituar shumicën e nevojshme në Kuvend për të formuar Qeverinë. (theks i shtuar)

Nëse kandidati i propozuar nga Presidenti merr miratimin e shumicës së votave të deputetëve në Kuvend, Presidenti i Republikës autorizohet dhe kërkohet, sipas nenit 84 (14) të Kushtetutës:

cakton mandatarin për formimin e Qeverisë, pas propozimit të partisë politike ose të koalicionit, që përbën shumicën e Kuvendit; (theks i shtuar)

Nëse kandidati i propozuar nuk zgjidhet nga shumica e anëtarëve të Kuvendit, neni 95, paragrafi 4 parasheh që Presidenti:

“... brenda dhjetë (10) ditësh emëron kandidatin tjetër sipas së njëjtës procedurë”.

Prandaj, nenet 84 (14) dhe 95, paragrafi 1, të Kushtetutës janë në përputhshmëri dhe konsistente. Të dy nenet, neni 84 dhe 95, e drejtojnë dhe e autorizojnë Presidentin që të propozojë dhe të emërojë një kandidat për Kryeministër, që të konsultojë partinë politike **ose** koalicionin që ka shumicën e nevojshme në Kuvend për të formuar

Qeverinë. Ka shumë gjasa që hartuesit e Kushtetutës kishin për qëllim që termi “partia politike ose koalicioni që përbën shumicën në Kuvend” në nenin 84 (14) e ka kuptimin e njëjtë me “partinë politike ose koalicionin që ka fituar shumicën e nevojshme në Kuvend për të formuar Qeverinë” në nenin 95.1. Në të vërtetë, përpara se Presidenti të mund të emërojë Kryeministrin, në pajtim me nenin 84 (14), ai kandidat duhet të ketë marrë miratimin e partisë ose të koalicionit në Kuvend, që përbën shumicën e Kuvendit, jo të partisë politike ose të koalicionit që ka fituar zgjedhjet.

Për qëllim të interpretimit të neneve 95, paragrafi 1, dhe 84 (14), të Kushtetutës, Gjykata gjithashtu është pyetur nëse një “parti politike” ose “koalicion” duhet të ekzistojë para se të mbahen zgjedhjet parlamentare. Edhe pse ligjet për zgjedhje në Kosovë mund të vendosin disa kufizime lidhur me atë se kush ose çfarë mund të jetë një “parti politike” ose “koalicion” për qëllim të pjesëmarrjes në zgjedhje, Kushtetuta nuk ka kufizim të ngjashëm lidhur me atë nëse subjekti duhet të ekzistojë para zgjedhjeve. Për shembull, Ligji për Zgjedhje në Kosovë, Nr. 03/L-073, e definon “koalicionin” dhe “partitë politike.” Ligji i lartcekur ka të bëjë me mbajtjen e zgjedhjeve dhe me atë se kush mund të merr pjesë në to, e jo me procedurën e emërimit të Kryeministrit në Kuvend.

Është me rëndësi të rikujtohet se Kushtetuta e Republikës së Kosovës është ratifikuar më 9 prill 2008 dhe ka hyrë në fuqi më 15 qershor 2008. Ligji për Zgjedhje në Kosovë, Nr. 03/L-073, lidhur me partitë politike dhe koalicionet që dëshirojnë të marrin pjesë dhe të garojnë në zgjedhje në Kosovë, ishte nxjerrë më 5 qershor 2008, 57 ditë pas ratifikimit të Kushtetutës. Edhe Kushtetuta edhe Ligji për Zgjedhje e përdorin termin “koalicione”. Nuk ka ndonjë autoritet që mund të konstatojë se termi “koalicion” ka kuptimin e njëjtë si në Kushtetutë ashtu edhe në Ligj, i cili është nxjerrë pasi është aprovuar Kushtetuta. Prandaj, do të ishte gabim të supozohej se hartuesit e Kushtetutës, me përdorimin e termit “koalicion” në Kushtetutë, kishin për qëllim që ai term të interpretohej në mënyrë të ngjashme me atë si mund të interpretohet në Ligjin për Zgjedhje. Për shembull, Ligji për Zgjedhjet kërkon që një “koalicion” mund të regjistrohet zyrtarisht në një numër të caktuar të ditëve para zgjedhjeve, në mënyrë që të lejohet të marrë pjesë dhe të garojë në zgjedhje. Kushtetuta nuk ka ndonjë kufizim të ngjashëm ose interpretim se çka përbën një “koalicion”. *Merriam Webster Dictionary*, në anën tjetër, e definon përdorimin më të shpeshtë të termit “koalicion”, si:

“një grup i njerëzve, grupe, ose vende që janë bashkuar për një qëllim të përbashkët”.

Është e arsyeshme të konkludohet se hartuesit e Kushtetutës e synonin këtë definicion, e jo atë më restriktiv në Ligjin për Zgjedhje, për të cilin ata nuk kanë mundur të dinë kur e miratuan Kushtetutën.

Ka shumë gjasa që hartuesit e Kushtetutës morën parasysh Rregulloren nr. 2001/9 për Kornizën Kushtetuese të Vetëqeverisjes së Përkohshme në Kosovë, kur ata i hartuan nenet 95 dhe 84 (14) të Kushtetutës. Kjo Rregullore kishte ekzistuar gjatë tetë vjetëve të kaluara dhe ishte korniza qeverisëse për Institucionet e Përkohshme të Vetëqeverisjes së Kosovës. Në lidhje me emërimin e Kryeministrit, neni 9.3.8 i Kornizës Kushtetuese është udhëzues përkitazi me synimin e hartuesve të Kushtetutës aktuale. Ai në mënyrë specifike parashikon:

Zgjedhja e Kryeministrit dhe ministrave

9.3.8 Pas zgjedhjeve, ose në rast se Kryeministri jep dorëheqjen apo nëse vendi i tij mbetet i lirë për arsye të tjera, Kryetari i Kosovës, pas konsultimeve me partitë politike të përfaqësuara në Kuvend, ia propozon Kuvendit një kandidat për Kryeministër. Kandidati i propozuar i paraqet Kuvendit një listë me ministrat e propozuar. Kryeministri bashkë me ministrat zgjidhen nga shumica e deputetëve të Kuvendit. (Theks i shtuar).

Ashtu si Kushtetuta aktuale, Korniza Kushtetuese e autorizonte Presidentin e Kosovës që të konsultohet me jo vetëm një parti të vetme politike në Kuvend, por me parti të shumta, me koalicione dhe me grupe në Kuvend me të njëjtin qëllim që Presidenti të propozojë kandidatin për Kryeministër që kishte më shumë gjasa të zgjidhej nga shumica e anëtarëve të Kuvendit. Ashtu si Kushtetuta e tanishme, Korniza Kushtetuese nuk kërkonte që "koalicionet ose grupet" të jenë të regjistruara apo të ekzistojnë formalisht para zgjedhjeve për Kuvend, në mënyrë që të konsultohen me Presidentin e Kosovës lidhur me vendimin e tij ose të saj për të propozuar një kandidat për Kryeministër.

Në të vërtetë, praktika e mëparshme në Kosovë e emërimit të Kryeministrit ka lejuar "koalicion" formal ose joformal pas zgjedhjeve parlamentare, që është formuar qartazi për të lejuar emërimin e suksesshëm të Kryeministrit nga shumica në Kuvend. Në katër zgjedhjet e kaluara parlamentare në Kosovë, asnjë parti politike nuk fitoi shumicën absolute të vendeve në Kuvend. Në secilin prej rasteve të mëparshme, qoftë koalicion formal apo informal ishte formuar pas zgjedhjeve, në mënyrë që pastaj të lejohet që kandidati i propozuar për Kryeministër të fitojë miratimin e shumicës së nevojshme në Kuvend, për të formuar Qeverinë.

Sipas Kushtetutës, nga Kuvendi pritet që ta zgjedhë Kryeministrin me shumicën e votave të anëtarëve të Kuvendit. Nëse Kuvendi nuk është në gjendje që ta arrijë këtë objektiv kushtetues pas dy raundeve të votimit, atëherë duhet të ketë zgjedhje parlamentare. Është e arsyeshme që të arrihet në përfundimin se zgjedhjet pasuese parlamentare, të cilat mundën ose jo të rezultojnë me një Kuvend të ri që do të jetë në gjendje të zgjedhë një Kryeministër, nuk ishin preferuar nga hartuesit e Kushtetutës. Prandaj, është mjaft e qartë se hartuesit e Kushtetutës kishin për qëllim që Presidentit t'i jepnin autorizim të gjerë për nominimin e një kandidati, i cili do të kishte mundësinë më të mirë të fitojë miratimin e shumicës së nevojshme në Kuvend, për ta formuar Qeverinë, për të maksimizuar mundësinë e zgjedhjes së suksesshme të këtij kandidati në Kuvend.

Kushtetuta kërkon që Kryeministri duhet të miratohet nga shumica në Kuvend para se ai ose ajo të mund të emërohen. Kushtetuta autorizon dhe kërkon nga Presidenti që të konsultohet **ose** me partinë kryesore politike **ose** me koalicionin në Kuvend, të nevojshëm për të formuar Qeverinë para se t'i propozohet Kuvendit një kandidat për Kryeministër. Kjo kërkesë duhet t'i maksimizojë mundësitë që kandidati i propozuar do të miratohet në mënyrë që të shmanget shpërndarja e Kuvendit dhe zgjedhjet pasuese, të cilat mundën ose jo të jenë njësoj të pasuksesshme në mundësinë e formimit të një Qeverie. Hartuesit e Kushtetutës kishin për qëllim që shumica e anëtarëve të Kuvendit duhet të zgjedhin Kryeministrin e tyre. Çdo interpretim tjetër mund të çojë në situatë ku Kryeministri të mos ketë mbështetjen e anëtarëve në Kuvend, që rrjedhimisht do të rezultonte në dështimin pothuajse të sigurt të Qeverisë, që nuk do të mund të ishte synimi i hartuesve të Kushtetutës.

Shumica e kësaj Gjykate ka arritur në përfundimin e gabuar se hartuesit e Kushtetutës kishin për qëllim që shprehja "ka fituar shumicën e nevojshme në

Kuvend për të formuar Qeverinë", siç paraqitet në nenin 95.1 të Kushtetutës e ka kuptimin si "shumica që kishte fituar zgjedhjet e mëparshme", edhe pse në Kushtetutë një shprehje e tillë nuk është përdorur ose referuar ndonjëherë. Është e rëndësishme të dihet se hartuesit kishin kuptuar se në shumë raste partia politike ose koalicioni i formuar para zgjedhjeve mund të mos fitojë shumicën absolute të vendeve në Kuvend, që rezulton me pluralizëm të partive që fitojnë vende në Kuvend. Në qoftë se kjo ndodh, si në të gjitha zgjedhjet parlamentare në Kosovë deri më sot, shumica e Gjykatës nuk arrin të shpjegojë se si shprehja "e nevojshme për të formuar Qeverinë" thjesht do të thotë partia politike apo koalicioni që ka marrë më shumë vota në zgjedhjet e mëparshme, edhe pse për të formuar Qeverinë një grup i tillë do të kishte nevojë për miratim jo vetëm nga anëtarët e partisë së tyre politike ose koalicionit që mund të ketë qenë formuar para zgjedhjeve.

Shumica e Gjykatës gjithashtu konstaton se, në qoftë se kandidati i parë i propozuar nga Presidentja nuk arrin të miratohet nga shumica e anëtarëve të Kuvendit, atëherë ajo duhet të përdorë një procedurë tjetër për të propozuar kandidatin tjetër për Kryeministër. Ky përfundim është qartazi i gabuar dhe e injoron gjuhën e qartë të nenit 95.4 të Kushtetutës. Ai nën shprehimisht parasheh:

Nëse përbërja e propozuar e Qeverisë nuk merr shumicën e votave të nevojshme, Presidenti i Republikës së Kosovës, brenda dhjetë (10) ditësh emëron kandidatin tjetër sipas së njëjtës procedurë. (theks i shtuar)

Edhe një herë, Presidentja mund të konsultohet me këdo që ajo beson se është parti politike ose koalicion, që përbën shumicën e nevojshme në Kuvend për të formuar Qeverinë.

E dorëzoi me respekt,


Robert Carolan
Gjyqtar

